



103

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA VLORE
DREJTORIA JURIDIKE

Nr. 9814 prot.Vlorë, më 19.06 2025

PROJEKTVENDIM

Nr. ____ datë ____ 2025

**"PËR DHËNIE TITULLI "QYTETAR NDERI I VLORES "PROF. Dr. ANDI
HOXHAI"**

Bazuar në Ligjin nr.139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetqeverisjen vendore", i ndryshuar neni 8 pika 2, pika 9.1, pika 1.1./b dhe pika 7/a, neni 54 pika m; në Ligjin nr. 112/2013 datë 04.04.2013 "Për Dekoratat, Titujt e Nderit, Medaljet dhe Titujt Vendorë të Nderit në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, neni 14, neni 15, pika 1/a dhe 2/b, neni 16, Ligji Nr 94/2022 datë 22.12.2022 "Për Titujt e Nderit dhe Titujt Vendorë të Nderit", me propozim të Qendrës Rinore Vlorë, sipas shkresës datë 09.06.2025 të depozituar pranë Protokollit të Bashkisë Vlorë, me Nr 9014 Prot, datë 09.06.2025 të miratuar nga Komisioni Këshillimor për Titujt Vendorë të Nderit të Këshillit të Bashkisë me Vendimin Nr. 5 date 18.06.2025, si dhe ne relacionin e paraqitur nga administrata e Bashkisë së bashku me dokumentacionin shoqërues, Këshilli i Bashkisë Vlorë në mbledhjen e datës ____, ____, 2025.

VENDOSI:

1.T'i japë titullin "Qytetar Nderi i Vlorës" Prof. Dr. Andi Hoxhaj me këtë motivacion:

"Për kontribut të shquar në promovimin e Shqipërisë dhe të qytetit të Vlorës, në mbrojtjen e interesave të shqiptarëve në diasporë si dhe për forcimin e mardhënieve ndërmjet Mbretërisë së Bashkuar dhe Shqipërisë"

2. Për zbatimin e këtij projektvendimi ngarkohet Kryetari dhe Administrata e Bashkisë Vlorë.

3.Ky vendim hyn në fuqi bazuar ne Ligjin nr.139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetqeverisjen vendore" neni 55 pika 6.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORE
DREJTORIA JURIDIKE

Nr 9814 Prot

Vlorë, më 19.06.2025

RELACION

Mbi projektvendimin “Për dhënie Titulli Qytetar Nderi i Vlorës Z. Andi Hoxhaj”

Para Këshillit të Bashkisë.

Të nderuar këshilltarë !

Projektvendimi për të vlerësuar me “Titullin Qytetar Nderi i Vlorës” Prof. Dr. Andi Hoxhaj lidhet me një nga personalitetet e shquara vlonjat të njohur ndërkombtarisht.

Ky propozim i është drejtuar Këshillit të Bashkisë nga Organizata Qendra Rinore Vlorë dhe është miratuar nga Komisioni Këshillimor për “Titujt Vendor të Nderit” pranë Këshillit të Bashkisë, vendim nr.5, datë 18.06.2025.

Z. Andi Hoxhaj ka lindur në Vlorë. Ai aktualisht është pedagog në universitetet prestigjoze në Britaninë e Madhe dhe një nga figurat më të shquara shqiptare në diasporë. Ai ka përfaqësuar denjësisht interesat e shqiptarëve përmes angazhimeve publike, akademike e institucionale, si para parlamentit Britanik dhe në organizata të ndryshme ndërkombëtare . Për këtë kontribut është dekoruar nga Mbreti Charlsi III me titullin e lartë “Officer of the Most Excellent Order of the British Empire në vitin 2024”. Ka dhënë gjithashtu opinione për zhvillimin e Shqipërisë. Kjo veprimtari dhe angazhim i tij ka ndikuar jo vetëm për njohjen e Shqipërisë në tërësi, por edhe te qytetit të Vlorës në veçanti.

Për gjithë këto, i propozojmë Këshillit të Bashkisë të miratojë këtë projektvendim si shenjë e mirënjohjes dhe respektit ndaj këtij personaliteti të shquar.

Bashkëlidhur këtij projektvendimi dokumentacioni shkresor i depozituar nga propozuesit.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORE

Nr 942 Prot

Vlorë, më 18.06. 2024

VENDIM
Nr 5, Datë 18.06.2025

Bazuar në Rregulloren e Komisionit Këshillimor “Për titujt vendorë të nderit, kriteret dhe procedurën e dhënies së tyre, si dhe për emertimin e rrugëve, shesheve, territoreve, institucioneve dhe objekteve në juridiksionin e Bashkisë Vlorë”, neni 10, pika 4 e në vijim, si dhe në propozimet e institucioneve, shoqatve dhe individëve për vlerësimin e personaliteteve të njohura në qytetin e Vlorës, Komisioni Këshillimor për Titujt Vendor të Nderit, pranë Keshillit të Bashkisë Vlorë.


VENDOSI:

Të miratojë propozimet e paraqitura , si më poshtë:

1. Vlerësim me Titullin “ Qytetar Nderi i Vlorës ”Znj. Mira Murati”
2. Vlerësim me Titullin “ Qytetar Nderi i Vlorës ”Z. Josif Gjipali”
3. Vlerësim me Titullin “ Qytetar Nderi i Vlorës “Prof. Dr. Andi Hoxhaj”

Ky Vendim ti përcillet Administratës dhe Këshillit të Bashkisë Vlorë , për procedurat e mëtejshme vendimmarrëse , bazuar në dispozitat ligjore ne fuqi.

KRYETAR I KOMISIONIT KËSHILLIMOR
Bardhosh Gaçe



9014
09.06.2025
KB

Adresa: Pallati i Kulturës "Labëria" Kati I, Vlorë, AL
Tel/fax: +355 33 203064
E-mail: vlorayouthcenter@gmail.com
Facebook: Qendra Rinore e Vlores/Vlora Youth Center
Instagram: vlorayouthcenter

Nr. 2 prot.

Vlorë, më 9 Qershor 2025

Kërkesë për shpalljen "Qytetar Nderi i Vlorës" të Prof. Dr. Andi Hoxhaj OBE

Drejtuar: Z. Ermal Dredha, Kryetar i Bashkisë Vlorë
Znj. Elpiniqi Mërkuri, kryetare e Këshillit të Bashkisë Vlorë
Anëtarëve të Këshillit Bashkiak Vlorë

Për djeni: Komisionit Këshillimor për Medaljet dhe Titujt Vendorë të Nderit të Bashkisë Vlorë

Lënda: Kërkesë për shpalljen "Qytetar Nderi i Vlorës" të Prof. Dr. Andi Hoxhaj OBE


Tw nderuar pwrfaqwsues tw Kwshillit Bashkiak Vlorw.

Shoqata Qendra Rinore e Vlorës, e regjistruar me numër vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë nr.449, më datë 12/11/2002, si një organizatë që punon prej vitesh në Vlorë, paraqet pranë jush kërkesën për shpalljen e "Qytetar Nderi i Vlorës" të Prof. Dr. Andi Hoxhaj OBE.

Bazuar në Ligjin nr. 139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar neni 8, neni 9.1, pika 1.1/a dhe b, pika 1.7/a dhe b, neni 54 pika a, k, l dhe m, në Ligjin nr. 112/2013 datë 04.04.2013 "Për Dekoratat, Titujt e Nderit, Medaljet dhe Titujt Vendorë të Nderit në Republikën e Shqipërisë" neni 17 dhe në vijim, në Ligjin nr.94/2022 datë 22.12.2022 "Për Titujt e Nderit dhe Titujt Vendorë të Nderit në Republikën e Shqipërisë", në VKM nr.861 datë 10.02.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Hollëshishme për Funksimimin e Komisioneve Këshillimore për Dhënie të Medaljeve dhe Titujt Vendorë të Nderit në Republikën e Shqipërisë" si dhe Rregullores të Komisionit Këshillimor "Për Titujt Vendorë të Nderit, Kriteret dhe Procedurën e dhënies së tyre si dhe emërtimin e Rrugëve, Shesheve, Territoreve, Institucioneve dhe objekteve në juridiksionin e Bashkisë Vlorë", aprovuar me vendim nr.56 të KB, datë 27/06/2024

Në mbështetje të akteve ligjore, kam nderin të paraqes pranë jush këtë kërkesë për shpalljen "Qytetar Nderi i Vlorës" të Prof. Dr. Andi Hoxhaj OBE, si një nga figurat më të shquara shqiptare në diasporë që ka dhënë një kontribut të spikatur në promovimin e Shqipërisë dhe vlerave tona qytetare në arenën ndërkombëtare.

Prof. Andi Hoxhaj është aktualisht pedagog pranë një prej universiteteve më elitare në Britaninë e Madhe si King's College London, ku drejton programin e studimeve pasuniversitare në të drejtën evropiane (European Law LLM Pathway). Ai është diplomuar me titullin Doctor of Philosophy in Laws (PhD) dhe më herët ka përfunduar LLM në Qeverisjen Korporative Ndërkombëtare dhe Rregullimin Financiar pranë University of Warwick dhe LLB në të drejtë pranë London Metropolitan University.



Adresa: Pallati i Kulturës "Labëria" Kati I, Vlorë, AL
Tel/fax: +355 33 203064

E-mail: vlorayouthcenter@gmail.com

Facebook: Qendra Rinore e Vlores/Vlorë Youth Center

Instagram: vlorayouthcenter

Përpara angazhimit në King's College, ka qenë pedagog në University College London dhe studiues pranë University of Warwick, ku është nderuar me çmimin **"The Warwick Award for Teaching Excellence 2021"** për kontributin e tij të shkëlqyer në mësimdhënie.


Prof. Hoxhaj ka përfaqësuar me dinjitet interesat e shqiptarëve dhe ka promovuar imazhin e Shqipërisë përmes angazhimeve të tij të shumta publike, akademike dhe institucionale. Ndër kontributet më të rëndësishme veçohen:

- **Dëshmitë para Parlamentit Britanik**, ku ka dhënë ekspertizë për çështje që lidhen me Ballkanin Perëndimor dhe Shqipërinë, përfshirë:
 - "The UK and the future of the Western Balkans" (2018)
 - "Asylum and Migration: Albania" (2022)
 - "The UK's strategy for the Western Balkans: spotlight on violence and instability in Kosovo and Serbia" (2024)
- **Kontributi në formësimin e marrëdhënieve dypalëshe** ndërmjet Mbretërisë së Bashkuar dhe Shqipërisë, duke kontribuar në hartimin e pjesëve kyçe të **"UK-Albania Joint Communiqué: Enhancing Bilateral Cooperation in Areas of Common Interest"**, e firmosur në dhjetor 2022 nga Kryeministrat e të dy vendeve.
- **Angazhimi me organizata ndërkombëtare si Freedom House dhe Global Initiative Against Transnational Organized Crime**, ku ka ofruar ekspertizë në fushat e së drejtës së BE-së, sundimit të ligjit, korrupsionit dhe integritetit evropian të Ballkanit Perëndimor.

Për kontributin e tij të veçantë në forcimin e marrëdhënieve midis Mbretërisë së Bashkuar dhe Shqipërisë, Prof. Dr. Andi Hoxhaj është dekoruar nga Mbreti Charles III me titullin e lartë **Officer of the Most Excellent Order of the British Empire (OBE)** në listën e Nderimeve të Vitit të Ri 2024. Ky është një ndër vlerësimet më të larta që i jepet një shtetasi shqiptar në Mbretërinë e Bashkuar dhe përbën një akt nderimi për mbarë kombin shqiptar.

Ai është gjithashtu **fellow i Institutit Mbretëror për Studime të Mbrojtjes dhe Sigurisë (Royal United Services Institute)**, dhe është i cituar gjerësisht në media ndërkombëtare për analizat dhe opinionet e tij mbi zhvillimet në Shqipëri dhe rajon.

Prof. Dr. Andi Hoxhaj, i lindur në Vlorë, dhe me një rrugëtim të shkëlqyer akademik e qytetar në arenën ndërkombëtare, përfaqëson me dinjitet vlerat më të mira të qytetarisë vlonjate, dijes dhe përkushtimit ndaj Shqipërisë. Ai ka qenë një zë i fuqishëm për të drejtat e shqiptarëve, për promovimin e imazhit të Shqipërisë dhe për forcimin e marrëdhënieve ndërkombëtare të vendit tonë, duke nderuar kështu në mënyrë të veçantë vendlindjen e tij, Vlorën.



Adresa: Pallati i Kulturës "Labëria" Kati I, Vlorë, AL

Tel/fax: +355 33 203064

E-mail: vlorayouthcenter@gmail.com

Facebook: Qendra Rinore e Vlores/Vlora Youth Center

Instagram: [vlorayouthcenter](https://www.instagram.com/vlorayouthcenter)

Në këtë kuadër, propozojmë që Prof. Dr. Andi Hoxhaj të shpallet me titullin **"Qytetar Nderi i Vlorës"**, si mirënjohje për veprimtarinë e tij të shquar në dobi të kombit dhe për promovimin e vlerave të qytetit tonë në arenën ndërkombëtare.

Me respekt,

Për Qendra Rinore e Vlorës
Alketa Lamani



Curriculum Vitae



Emri / Mbiemri

Adresa:

Telefoni

E-mail

Nacionaliteti

Data dhe vendi i lindjes

Fusha Profesionale

Eksperiencat e punës

Periudha

Pozita që është ushtruar

Emri dhe adresa e punëdhënësit

Periudha

Pozita që është ushtruar

Emri dhe adresa e punëdhënësit

Periudha

Pozita që është ushtruar

Emri dhe adresa e punëdhënësit

Edukimi

Datat

Titulli i kualifikimit të marre

Emri i institucionit

Datat

Titulli i kualifikimit të marre

Emri i institucionit

Datat

Titulli i kualifikimit të marre

Emri i institucionit

Kerkim Shkencor dhe publikime

Liber dhe kapituj shkencor

Artikuj shkencor

Dr Andi Hoxhaj, OBE

Londer, Britaninë e Madhe

+44 (0) 7825154107

andi.hoxhaj1@gmail.com

Shqiptare/ Britanik

7 Maj 1988, Vlore, Shqiperi

Akademik dhe Hulumtues i se Drejtes se Bashkimit Europian

Lekotë në Universitetin "King's College London", Fakulteti i Drejtesise

Shtator 2024-ne vazhdim

Lekotë dhe Drejtori i programit të Masterit të Drejtes se Bashkimit Europian

The Dickson Poon School of Law, King's College London, London, WC2R 2LS

Shtator 2022-Shtator 2024

Lekotë në Universitetin "University College London", Fakulteti i Drejtesise

UCL Faculty of Laws, 4-8 Endsleigh Gardens, London WC1H 0EG

Shtator 2017-Shtator 2022

Pedagog në Universitetin "University of Warwick", Fakulteti i Drejtesise

University of Warwick, Warwick Law School, Library Rd, Coventry CV4 7AL

Shtator 2013- Qershor 2017

Doktor Shkencash (PhD) të Filozofise se Drejtesise

University of Warwick

Shtator 2011- Qershor 2012

Master (LLM) i se Drejtesise Nderkombatar dhe Rregullorja Financiare

University of Warwick

Shtator 2008- Qershor 2011

Bachelor (LLB) në Drejtesise

London Metropolitan University

Hoxhaj, A. (2020) *The EU Anti-Corruption Report: A Reflexive Governance Approach*, (Routledge)

Hoxhaj, A. (2023) 'Stabilising the Western Balkans through a Common Market: Opportunities and Challenges', in J Džankić, S Kacarska and S Keil (eds), *A Year Later: War in Ukraine and Western Balkan (Geo)Politics* (EUI Press), pp. 86-98

Hoxhaj, A. (2025) 'The EU Enlargement Law in Context', *European Law Journal* (accepted)

Hoxhaj, A. (2022) 'The EU Common Market Initiative for the Western Balkans', *Legal Issues of Economic Integration*, 49(3): 1-28

Hoxhaj, A. (2022) 'The CJEU Validates in C-156/21 and C-157/21 the Rule of Law Conditionality Regulation Regime to Protect the EU Budget', *Nordic Journal of European Law* 5(1): 131-144

Hoxhaj, A. (2022) 'The CJEU in *Commission v Hungary Higher Education Defends Academic Freedom Through WTO Provisions*', *The Modern Law Review*, 85(3): 773-786

Hoxhaj, A. (2021) 'The EU Rule of Law Initiative Towards the Western Balkans', *Hague Journal on the Rule of Law*, 13(1): 143-172

Hoxhaj, A., and Zhilla, F. (2021) 'The Impact of Covid-19 Measures on the Rule of Law in the Western Balkans and the Increase of Authoritarianism', *European Journal of Comparative Law and Governance*, 8(4): 271-303

Botime te ndryshme

Robertson, G., and Hoxhaj, A. (2024) 'NATO must tackle instability in the Balkans', *The Economist*, 2 Korrik 2024

Hoxhaj, A. (2023) 'Albania's brain drain: why so many young people are leaving and how to get them to stay', *The Conversation*, 28 Qershor 2023

Hoxhaj, A. (2022) 'Albania's ghost towns: the crisis that caused the exodus', *The Conversation*, 11 Nentor 2022

Çmime dhe fonde per kerkim shkencor

UCL Public Policy Advisory Scheme (UKRI-IAAs) and Arts and Humanities Research Council 'Albanian migrants in the UK', £65,000, Shkurt 2023

Stiftung Mercator Fellowship Programme 2021-2022: 'The Politics of the EU Rule of Law and Anti-Corruption Reform', £16,500, Qershor 2021

British Academy 2018-2019: 'UK-Western Balkans Early Career Network on Migration, Security, Justice', £13,500, Prill 2018

Angazhime publike ne vendimarrje

Deshmuar para Komisionit Parlamentare per Punet e Jashtme per strategjin dhe politika e jashtme se Britanines ne Ballkan, Britanine e Madhe, Mars 2024

Deshmuar para Komisionit Parlamentare per Punet e Brendshme per azil-kerkuesit dhe emigrantet e paligjshem, Britanine e Madhe, Dhjetor 2023

Kontribut per perfshirjen e bashkepunimit ne fushen e arsimit ne marreveshjen mes Mbratrise se Bashkuar dhe Shqiperise te nenshkruar nga Kryeministri Rama dhe ish-kryeministri Sunak, Dhjetor 2022

Deshmuar para Komisionit Parlamentare per Punet e Jashtme per politika e jashtme se Britanines ne Ballkan pas Brexit, Britanine e Madhe, Janar 2018

Ligjratat ne konferenca shkencor

CJEU rules EncroChat encrypted data admissible in court, The Bingham Centre for the Rule of Law, Londer, Dhjetor 2024

The Western Balkans quest for EU Membership, Leiden University, Holande, Qershor, 2023

The EU and the Western Balkans, Gothenburg University, Suedi, Prill 2022

The EU Anti-Corruption Policy, Columbia University, Shtetet e Bashkuara te Amerikes, Shkurt 2021

Tituje nderit, medaljet dhe çmime

Oficer i Urdhrit te Perandorisë Britanik (OBE), nga Mbreti i Anglisë Charles III, per marredheniet mes Mbretrise se Bashkuar dhe Shqiperise, Janar 2024

Pedagog vitit per ekselences ne mesimdhenie, nga Univesity of Warwick, Korrik 2021

Yll ne ngritje, nga Akademia e Shkencave se Britanines se Madhe, Prill 2022